



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E FINANCEVE BANKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 8709 prot.

Nr. 4133 prot.

Nr. 1156 prot.

Tiranë, më 20 . 5 .2026

Tiranë, më 20 . 05 .2026

Tiranë, më 20 . 05 .2026

MEMORANDUM MIRËKUPIMI

PËR STATISTIKAT E FINANCEVE TË QEVERISË DHE PROCEDURËS SË DEFICITIT TË TEPËRT (PDT/SFQ)

midis

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE (INSTAT)

dhe

BANKËS SË SHQIPËRISË (BSH)

dhe

MINISTRISË SË FINANCEVE (MF)

TIRANË _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BSH	Banka e Shqipërisë
COFOG (eng.)	Shpenzimet e Qeverisë sipas Funksionit
ESA 2010 (eng.)	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
ESTAT (eng.)	Eurostat
FISIM (eng.)	Shërbimet e Ndërmjetësimit Financiar të Matura Indirekt
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GFSM 2014 (eng.)	Manuali i Statistikave Financiare të Qeverisë 2014
INSTAT	Instituti i Statistikave
KE	Komisioni Evropian
LHSH	Ligji për Huamarrjen Shtetërore
MGDD (eng.)	Manuali i Borxhit dhe Deficitit të Qeverisë
MF	Ministria e Financave
MM	Memorandum Mirëkuptimi
PDT (EDP)	Procedura e Deficitit të Tejkualuar
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
SFQ	Statistikat Financiare të Qeverisë
SIFQ	Sistemi i Informacionit Financiar të Qeverisë
SIPSFQ	Sistemi i Integruar i Përpilimit të Statistikave Financiare të Qeverisë
SSHÇE	Sekretariati Shtetëror i Çështjeve Ekonomike
STBP	Statistikat Tremujore të Borxhit Publik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PËRMBAJTJA

Neni 1 - Qëllimi	4
Neni 2 - Baza ligjore	5
Neni 3 - Përkufizimi i Përgjegjësisë	6
Neni 4 - Prodhimi i Llogarive Jofinanciare	7
Neni 5 - Llogaritë Financiare	7
Neni 6 - Sistemi i Integruar i Përpilimit të Statistikave Financiare të Qeverisë	8
Neni 7 - Statistikat Financiare të Qeverisë	9
Neni 8 - Tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkualuar	10
Neni 9 - Klasifikimi i njësive sipas sektorëve institucionalë	11
Neni 10 - Shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit	12
Neni 12 – Informimi i Palëve.....	13
Neni 13 - Transmetimi, publikimi dhe shpërndarja e të dhënave	13
Neni 14 - Organizimi dhe bashkëpunimi	14
Neni 15. Respektimi i kompetencave institucionale.....	14
Neni 16 - Përditësimet	15
Neni 17 - Hyrja në fuqi dhe Shfuqizime	15
Neni 18 - Të tjera	15
ANEKS:.....	16
Tabelë: Institucionet përgjegjëse për përgatitjen dhe raportimin e Statistikave Financiare të Qeverisë dhe Tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar	16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e prodhimit të statistikave të besueshme dhe të krahasueshme për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme, në përputhje me standardet metodologjike të Bashkimit Evropian dhe kërkesat e Sistemit Evropian të Llogarive (ESA 2010), si dhe nevojën për koordinim institucional për përmbushjen e detyrimeve të raportimit statistikor ndaj institucioneve evropiane dhe ndërkombëtare, Palët bien dakord të formalizojnë bashkëpunimin e tyre përmes këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Ky Memorandum synon gjithashtu të sigurojë një kuadër të qartë për koordinimin ndërinstitucional në prodhimin, shkëmbimin dhe raportimin e statistikave të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme, në përputhje me standardet metodologjike të Bashkimit Evropian dhe kërkesat e Eurostat.

Në këtë Memorandum Mirëkuptimi (MM), Palët bien dakord:

1. të bashkëpunojnë për prodhimin dhe zhvillimin e statistikave makroekonomike dhe financiare, të rregulluara nga legjislacioni kombëtar, duke zbatuar standardet metodologjike të përcaktuara në aktet ligjore të Bashkimit Evropian (BE) dhe programet zyrtare statistikore, me qëllim përcaktimin e qartë të përgjegjësisë të secilës Palë në përpilimin dhe raportimin e statistikave përkatëse;
2. të bëjnë përpjekje për minimizimin e barrës raportuese, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe të të dhënave administrative, vrojtimeve statistikore, regjistrave statistikore dhe burimeve të tjera të disponueshme nga secila Palë, përfshirë shkëmbimin e informacionit konfidencial për qëllime të prodhimit të statistikave zyrtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
3. të marrin parasysh nevojat e Palëve të tjera gjatë hartimit të formularëve për mbledhjen e informacioneve statistikore nga njësitë statistikore;
4. të konsultohen përpara miratimit ose rishikimit të formularëve raportues apo vrojtimeve statistikore, përmes të cilëve mblidhet informacion i dobishëm për përmbushjen e detyrave të tyre ligjore, si agjenci statistikore. Formularët ose pyetësorët përkatës duhet të përmbajnë informacion për qëllimin e mbledhjes së të dhënave dhe për shkëmbimin e tyre ndërmjet Palëve;
5. të bashkëpunojnë për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe teknologjike, duke përfshirë organizimin e veprimtarive trajnuese mbi metodologjitë statistikore, zhvillimin dhe përdorimin e aplikacioneve dhe sistemeve të informacionit, me qëllim përmirësimin e integritetit dhe përputhshmërisë së bazave të të dhënave dhe burimeve statistikore të administruara nga secila Palë;
6. të përdorin standardet dhe udhëzimet përkatëse statistikore të përcaktuara në aktet ligjore të Bashkimit Evropian si referencë metodologjike për prodhimin dhe raportimin e statistikave makroekonomike të kërkuara nga Eurostat.

Neni 1 - Qëllimi

- 1.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi rregullon marrëdhëniet ndërinstitucionale ndërmjet Institutit të Statistikave (INSTAT), Bankës së Shqipërisë (BSH) dhe Ministrisë së Financave (MF) (në vijim "Palët"), duke përcaktuar përgjegjësitë për përpilimin, publikimin, transmetimin dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

shkëmbimin e të dhënave, si dhe fushat dhe kushtet e bashkëpunimit për prodhimin e statistikave zyrtare të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme, në kuadër të Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ).

1.2 Përveç shkëmbimit të të dhënave, bashkëpunimi midis Palëve synon gjithashtu:

- a) sigurimin e cilësisë dhe konsistencës së statistikave të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme, në përputhje me standardet e përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian;
- b) përpilimin, publikimin, transmetimin dhe shkëmbimin e të dhënave statistikore të nevojshme për statistikën e financave të qeverisë (GFS) dhe Procedurën e Deficitit të Tepërt (PDT/EDP); zhvillimin e metodave, procedurave, teknikave dhe metodologjive të reja statistikore, si dhe përmirësimin e atyre ekzistuese;
- c) ngritjen e grupeve të punës për çështje specifike të parashikuara në këtë Memorandum;
- d) shkëmbimin e vazhdueshëm të dokumenteve zyrtare dhe teknike që kanë lidhje me fushën e statistikave PDT/GFS;
- e) bashkëpunimin për përpunimin e statistikave të qeverisë së përgjithshme, veçanërisht në lidhje me Procedurën e Deficitit të Tepërt (PDT) dhe Semestrin Evropian, me synim përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian lidhur me këtë fushë;
- f) bashkëpunimin në përpilimin e llogarive financiare dhe jofinanciare në përputhje me kërkesat e ESA 2010;
- g) bashkëpunimin në përpilimin e Statistikave Tremujore të Borxhit Publik (STBP).

1.3 Palët do të përdorin standardet dhe udhëzimet statistikore të përcaktuara në akte ligjore të BE-së, si referencë metodologjike për prodhimin dhe raportimin e statistikave makroekonomike, në përputhje me kërkesat e Eurostat-it, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 - Baza ligjore

2.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) mbështetet në:

- a) Ligjin nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare", i ndryshuar;
- b) Programin 5-vjeçar të Statistikave Zyrtare, të miratuar me ligj, si dhe Planin Vjetor për zbatimin e tij, të miratuar me vendimin përkatës të Kuvendit;
- c) Ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- d) Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën Shqipërisë", i ndryshuar;
- e) Ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën Shqipërisë", i ndryshuar.

2.2 Prodhimi dhe raportimi i statistikave të rregulluara nga ky Memorandum bazohet gjithashtu në standardet dhe aktet ligjore të Bashkimit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare, në veçanti:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- a) Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 479/2009, datë 25 maj 2009, mbi zbatimin e Protokollit për Procedurën e Deficitit të Tepërt (EDP), aneksuar në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, e ndryshuar;
- b) Rregulloren (EU) Nr. 549/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010);
- c) Programin e Transmetimit ESA 2010, si pjesë përbërëse e Rregullores (EU) Nr. 549/2013;
- d) Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 1222/2004, datë 28 qershor 2004, mbi përpilimin dhe transmetimin e të dhënave të borxhit tremujor të qeverisë, e ndryshuar nga Rregullorja (EU) Nr. 517/2013;
- e) Direktivën 2011/85/EU të Këshillit, datë 8 nëntor 2011, mbi kërkesat për kornizat buxhetore të shteteve anëtare;
- f) Udhëzimin e Bankës Qendrore Evropiane ECB/2013/23 mbi statistikave të financave të qeverisë, i ndryshuar dhe i plotësuar;
- g) Manualin për Deficitin dhe Borxhin e Qeverisë (MGDD), botimi më i fundit, i publikuar nga Eurostat;
- h) Manualin e Statistikave të Financave të Qeverisë (GFSM 2014), të Fondit Monetar Ndërkombëtar;
- i) Udhëzimet dhe praktikave metodologjike të publikuara nga Eurostat dhe Banka Qendrore Evropiane në fushën e statistikave të financave të qeverisë.

Neni 3 - Përkufizimi i Përgjegjësisë

3.1 Në kuadër të këtij Memorandumi, termi “përgjegjësi” i referohet kompetencës institucionale për të ndërmarrë veprime për zhvillimin, përpilimin dhe publikimin e statistikave makroekonomike dhe financiare, për të siguruar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe për të garantuar përdorimin e tyre vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.2 Termi “përgjegjësi e përbashkët” nënkupton që Instituti i Statistikave, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave bashkëpunojnë për prodhimin e statistikave të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme dhe të Procedurës së Deficitit të Tepërt (PDT/EDP), duke respektuar kompetencat institucionale të secilës palë dhe duke siguruar konsistencën metodologjike të statistikave.

3.3 Për të siguruar zbatimin e këtij Memorandumi, Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe përcaktojnë detyrat e përgjegjësitë sipas dispozitave vijuese të këtij Memorandumi.

3.4. Secila palë ushtron përgjegjësitë e saj statistikore në përputhje me kompetencat institucionale dhe legjislacionin në fuqi, ndërkohë që bashkëpunon me palët e tjera për të siguruar koherencën dhe cilësinë e statistikave të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme.

3.5 Përgjegjësitë e secilës palë dhe përgjegjësitë e përbashkëta të tyre në lidhje me përpilimin e tabelave PDT/EDP, paraqiten në Aneksin 1 bashkëngjitur këtij Memorandumi.



Neni 4 - Prodhimi i Llogarive Jofinanciare

4.1 INSTAT është përgjegjës për përpilimin e llogarive jofinanciare sipas sektorëve institucionalë dhe transmetimin e tyre në përputhje me Programin e Transmetimit ESA 2010.

4.2 Për prodhimin e llogarive jofinanciare në përputhje me pikën 4.1 dhe kërkesat e Programit të Statistikave Zyrtare, palët bashkëpunojnë si më poshtë:

- a) BSH-ja furnizon INSTAT-in me të dhëna për sektorin institucional dhe nënsektorët e korporatave financiare, si dhe për sektorin "Pjesa tjetër e botës";
- b) MF-ja furnizon INSTAT-in me të dhëna të plota mujore për buxhetin, të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), me informacion sipas nënsektorëve të Qeverisë së Përgjithshme: Qeverinë Qendrore, Qeverinë Lokale dhe Fondet e Sigurimeve Shoqërore; sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas klasifikimit funksional të shpenzimeve (COFOG), si dhe pasqyrën financiare të konsoliduar të shpenzimeve dhe të të ardhurave të qeverisjes së përgjithshme;
- c) MF-ja dërgon setin e të dhënave për sektorin e Qeverisjes së Përgjithshme, me frekuencë vjetore dhe tremujore;
- d) MF-ja furnizon INSTAT-in me të dhënat lidhur me borxhin në "cash" dhe "accrual", të gjeneruara nga "Moduli i Borxhit" pjesë e SIPSFQ;
- e) Me kërkesë të MF-së, INSTAT-i furnizon MF-në me të dhënat për njësitë ekstra-buxhetore të nevojshme për përpilimin e statistikave të financave të qeverisë në përputhje me Manualin GFSM 2014.

4.3 INSTAT-i, në bashkëpunim me MF-në, përgatit tabelën ndërlidhëse për konvertimin e llogarive publike të Qeverisë së Përgjithshme të raportuara nga SIFQ në klasifikimet e llogarive sipas ESA 2010, si dhe pasqyrat financiare të njësive ekstra-buxhetore në klasifikimet e llogarive sipas ESA 2010.

Neni 5 - Llogaritë Financiare

5.1 Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për zhvillimin metodologjik, përpilimin dhe publikimin e llogarive financiare sektoriale tremujore dhe vjetore, në përputhje me kërkesat e ESA 2010 dhe udhëzimet statistikore të Bankës Qendrore Evropiane, në kuadër të bashkëpunimit statistikor brenda Sistemit Evropian të Bankave Qendrore.

5.2 Për realizimin e statistikave sipas pikës 5.1 të këtij neni, palët bashkëpunojnë si më poshtë:

- a) MF-ja furnizon BSH-në me të dhëna mujore lidhur me flukset e borxhit të jashtëm shtetëror dhe të garantuar (tërheqje të reja, pagesë principali, interesi dhe komisionet);
- a) MF-ja furnizon çdo tremujor BSH-në me të dhëna mujore në "cash" lidhur me gjendjen në fund të periudhës dhe flukset e borxhit të jashtëm shtetëror dhe të garantuar (stokun, tërheqje të reja, pagesë principali, interesi dhe komisionet);



- b) MF-ja furnizon BSH-në me të dhëna tremujore për gjendjet në fund të periudhës raportuese të llogarive financiare të qeverisë së përgjithshme në sistemin bankar;
- c) MF-ja furnizon BSH-në me të dhëna tremujore lidhur me borxhin në “cash” dhe “accrual”, të gjeneruara nga “Moduli i Borxhit” i hartuar sipas standartit të SIPSFQ;
- d) BSH-ja dhe INSTAT-i bashkëpunojnë për zgjerimin dhe përmirësimin e përdorimit të burimeve administrative me qëllim përmirësimin e mbulimit, cilësisë dhe harmonizimit të të dhënave të nevojshme për përpilimin e llogarive financiare dhe jofinanciare për të gjithë sektorët institucionalë;
- e) INSTAT-i furnizon MF-në dhe BSH-në me të dhënat e plota për njësitë ekstra-buxhetore të nevojshme për përpilimin e statistikave financiare të qeverisë, në përputhje me Manualin e Statistikave Financiare të Qeverisë (GFSM 2014).

5.3 BSH-ja përpilon llogaritë financiare për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme dhe bashkëpunon me Institutin e Statistikave për të siguruar konsistencën ndërmjet llogarive financiare dhe llogarive jofinanciare, në përputhje me metodologjinë ESA 2010.

5.4 BSH-ja publikon dhe transmeton llogaritë financiare tremujore dhe vjetore për të gjithë sektorët institucionalë të ekonomisë, në përputhje me Programin e Transmetimit ESA2010.

5.5 BSH-ja siguron, nëpërmjet sistemit SIPSFQ, të dhënat përkatëse mbi instrumentet financiare dhe detyrimet e sektorëve institucionalë për qëllime të përpilimit të statistikave makroekonomike dhe financiare.

5.6 BSH-ja siguron, nëpërmjet sistemit SIPSFQ, të dhënat për borxhin e sektorit financiar për qëllime të hartimit të STBP.

Neni 6 - Sistemi i Integruar i Përpilimit të Statistikave Financiare të Qeverisë

6.1 Për përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë (SFQ) dhe tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar (PDT) në Shqipëri, Palët bien dakord të përdorin Sistemin e Integruar të Përpilimit të Statistikave Financiare të Qeverisë (SIPSFQ), i cili përfshin të gjitha të dhënat përkatëse të tre institucioneve, në një sistem të vetëm përpilimi duke siguruar konsistencën ndërmjet llogarive jofinanciare dhe financiare të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme.

6.2 Për përpilimin e SFQ-ve dhe tabelave të PDT-së, Grupi i Përbashkët i Punës përgatit tabelat ndërlidhëse dhe dokumentacionin teknik përkatës sipas strukturave të përcaktuara, të cilat integrohen në sistemin SIPSFQ.

6.3 Sistemi SIPSFQ përfshin procedura të standardizuara dhe të automatizuara për përpilimin e treguesve të Statistikave të Financave të Qeverisë në përputhje me metodologjitë ESA 2010 dhe GFSM 2014, si dhe për përgatitjen e statistikave të borxhit të qeverisë. Këto procedura mundësojnë kontrollin e brendshëm të konsistencës së të dhënave dhe rakordimin e tyre me burimet përkatëse administrative dhe financiare.

6.4 INSTAT-i administron funksionimin operacional të sistemit SIPSFQ, ndërkohë që të tre Palët kanë akses në sistem dhe janë përgjegjëse për sigurimin dhe përditësimin e burimeve të tyre përkatëse të të dhënave.



6.5 SIPSFQ-i regjistron burimet e të dhënave, transformimet dhe rregullimet teknike ose metodologjike të kryera gjatë procesit të përpilimit të statistikave. Palët kanë akses në sistem për të ndjekur procesin e përpilimit të të dhënave të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme dhe për të siguruar transparencën dhe gjurmueshmërinë e ndryshimeve të kryera. INSTAT-i siguron akses në distancë dhe të sigurt në SIPSFQ për Palët, sipas Protokollit të Shkëmbimit të të Dhënave.

6.6 Palët përdorin “Sistemin e Integruar të Përpilimit të Statistikave Financiare të Qeverisë (SIPSFQ)” për koordinimin dhe përpilimin e statistikave makroekonomike dhe financiare të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme.

Neni 7 - Statistikat Financiare të Qeverisë

7.1 INSTAT-i është institucioni përgjegjës për përpilimin e Statistikave Financiare të Qeverisë (SFQ) për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme dhe transmetimin e tyre në Eurostat sipas Programit të Transmetimit ESA 2010.

7.2 SFQ-të paraqesin aktivitetet ekonomike të sektorit të Qeverisjes së Përgjithshme dhe përfshijnë ndër të tjera:

- a) të ardhurat gjithsej të qeverisë;
- b) shpenzimet gjithsej të qeverisë;
- c) bilancin e qeverisë (suficit (+) / deficit (-)), sipas konceptit të huadhënies (+) / huamarrjes neto (-) në kuadër të llogarive kombëtare;
- d) klasifikimin e shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG);
- e) detyrimet e krijuara dhe transaksionet në asetet financiare;
- f) ndryshime të tjera në asetet dhe detyrimet (ndryshime në volum dhe rivlerësime);
- g) pasqyrat e bilancit për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme.

7.3 Përpilimi i Statistikave të Financave të Qeverisë kryhet në bashkëpunim ndërmjet INSTAT-it, Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë nëpërmjet grupit të përbashkët të punës. Palët angazhohen të diskutojnë rregullisht çështje metodologjike dhe zhvillime të reja që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në përpilimin e statistikave.

7.4 Për përpilimin dhe koordinimin e Statistikave të Financave të Qeverisë dhe të tabelave të Procedurës së Deficitit të Tepërt, Palët përdorin Sistemin e Integruar të Përpilimit të Statistikave Financiare të Qeverisë (SIPSFQ), i cili mundëson integrimin e burimeve të të dhënave dhe siguron konsistencën ndërmjet statistikave jofinanciare dhe financiare të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme.

7.5 Ministria e Financave siguron burimet kryesore administrative të të dhënave për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme dhe përpilon statistikën e financave publike në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe me Manualin e Statistikave të Financave të Qeverisë (GFSM 2014) të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

7.6 Banka e Shqipërisë përpilon dhe transmeton statistikën e financave të qeverisë për qëllimet e raportimit statistikor në kuadër të Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, në përputhje me Udhëzuesin e Bankës Qendrore Evropiane për Statistikat e Financave të Qeverisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

7.7 Banka e Shqipërisë është gjithashtu përgjegjëse për përpilimin e statistikave tremujore të borxhit të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme sipas përkufizimit të Maastricht, në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Neni 8 - Tabelat e Procedurës së Deficitit të Tejkualuar

8.1 Instituti i Statistikave dhe Banka e Shqipërisë bashkëpunojnë në përgatitjen e tabelave të Procedurës së Deficitit të Tepërt (PDT), në përputhje me Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 479/2009, , të ndryshuar, si dhe me Manualin për Deficitin dhe Borxhin e Qeverisë (MGDD), botimi më i fundit.

8.2 Pavarësisht nga dispozita e paragrafit të parë të këtij neni, 2 Ministria e Financave është përgjegjëse për përgatitjen e të dhënave të planifikuara (forecast) për deficitin dhe borxhin e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme për vitin aktual, të cilat i vihen në dispozicion Institutit të Statistikave për përgatitjen e raportimit të PDT-së.

8.3 Instituti i Statistikave siguron koordinimin metodologjik të përgatitjes së tabelave të Procedurës së Deficitit të Tepërt dhe garanton përputhshmërinë e tyre me metodologjinë ESA 2010 dhe udhëzimet e Eurostat.

8.4 Tabelat e Procedurës së Deficitit të Tepërt transmetohen në Eurostat dy herë në vit, në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregulloren (EC) Nr. 479/2009.

8.5 Dy herë në vit, deri më 30 prill dhe 31 tetor, në përputhje me programin e transmetimit, INSTAT-i në bashkëpunim me BSH-në dhe MF-në, përgatit raportin e PDT-së për sektorin e Qeverisë së Përgjithshme. Ky raport bazohet në të dhënat për katër vitet e mëparshme dhe në parashikimet për vitin aktual, bazuar në buxhetet e miratuara dhe planet financiare të njësive të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme.

8.6 INSTAT-i është përgjegjës për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit metodologjik dhe procedural të raportimit të PDT-së (*EDP Inventory – Eng.*).

8.7 Instituti i Statistikave është institucioni përgjegjës për transmetimin zyrtar të njoftimit të Procedurës së Deficitit të Tepërt (*EDP notification – Eng.*) në Eurostat, në përputhje me kërkesat e Rregullores (EC) Nr. 479/2009 dhe metodologjinë ESA 2010.

8.8 Përgatitja e tabelave PDT kryhet nëpërmjet grupit të përbashkët të punës ndërmjet INSTAT-it, MF-së dhe BSH-së. Palët angazhohen të diskutojnë rregullisht çështje metodologjike që lidhen me trajtimin statistikor të transaksioneve dhe klasifikimin institucional, veçanërisht në rastet e transaksioneve të reja ose ndryshimeve metodologjike.

8.9 Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për përpilimin e statistikave të borxhit të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme sipas përkufizimit të Maastricht-it, në përputhje me metodologjinë ESA 2010 dhe Manualin për Deficitin dhe Borxhin e Qeverisë (MGDD), bazuar në të dhënat burimore të siguruar nga Ministria e Financave.

8.10 Instituti i Statistikave përdor këto të dhëna në përgatitjen e tabelave të Procedurës së Deficitit të Tepërt dhe publikon tabelën e rakordimit që paraqet kalimin nga borxhi i raportuar sipas



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

statistikave të financave publike në borxhin sipas përkufizimit të Maastricht-it, së bashku me shënimet metodologjike përkatëse.

8.11 MF-ja është përgjegjëse për përmbushjen e kërkesave të Direktivës së Këshillit 2011/85/EU mbi kornizat buxhetore të shteteve anëtare.

Pavarësisht nga dispozita e paragrafit të mësipërm, një tabelë rakordimi që paraqet metodologjinë për konvertimin e të dhënave të mbajtura në baza “*modified cash*” në të dhëna bazuar në standardin ESA2010 (neni 3 (2b) i Direktivës) do të përpilohet nga Instituti i Statistikave në bashkëpunim me MF-në. Instituti i Statistikave, gjithashtu, do të përpilojë dhe dërgojë në Eurostat të dhëna për nivelin e detyrimeve të korporatave publike të klasifikuara jashtë sektorit të Qeverisë së Përgjithshme.

8.12 Palët bashkëpunojnë dhe koordinojnë veprimet e tyre në rastin e vizitave dhe misionëve të organizuara nga Eurostat-i lidhur me çështjet e Procedurës së Deficitit të Tepërt.

8.13 Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet palëve lidhur me trajtimin metodologjik të një transaksioni apo klasifikimi institucional, palët do të përpiqen të arrijnë një zgjidhje nëpërmjet konsultimeve teknike. Në rast se nuk arrihet konsensus, çështja mund t’i referohet Eurostat-it për opinion metodologjik në përputhje me metodologjinë ESA 2010 dhe Manualin për Deficitin dhe Borxhin e Qeverisë (MGDD).

8.14 Palët angazhohen që trajtimi i mosmarrëveshjeve të mos pengojë respektimin e afateve zyrtare të raportimit EDP dhe të bashkëpunojnë për sigurimin e cilësisë, koherencës dhe integritetit të statistikave të raportuara.

Neni 9 - Klasifikimi i njësive sipas sektorëve institucionale

9.1 INSTAT-i është institucioni përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të njësive institucionale dhe për publikimin e listës së njësive që bëjnë pjesë në sektorin publik, në përputhje me metodologjinë ESA 2010 dhe duke respektuar legjislacionin për statistikën zyrtare dhe parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane.

9.2 INSTAT-i bashkëpunon me MF-në për identifikimin dhe klasifikimin e njësive institucionale që janë pjesë e raportimit në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë SIFQ, sipas sektorëve dhe nënsektorëve dhe sipas aktiviteteve ekonomike.

9.3 MF-ja është përgjegjëse për furnizimin e INSTAT-it me informacionin e nevojshëm për krijimin dhe përditësimin e listës së njësive institucionale që bëjnë pjesë në sektorin publik në Shqipëri.

9.4 INSTAT-i dhe MF-ja bashkëpunojnë për përgatitjen dhe publikimin e një liste të përbashkët të njësive institucionale të sektorit publik të klasifikuar sipas metodologjisë ESA 2010. Kjo listë - Lista e Institucioneve Publike, përdoret nga Palët për përpilimin e Statistikave të Financave të Qeverisë (SFQ), të borxhit sipas përkufizimit të Maastricht-it dhe tabelave të Procedurës së Deficitit të Tepërt (PDT).

9.5 BSH-ja është institucioni përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të njësive institucionale që bëjnë pjesë në sektorin financiar.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

9.6 MF-ja dhe BSH-ja informojnë INSTAT-in në rast se disponojnë informacion që mund të çojë në ndryshim të klasifikimit të një njësie institucionale ose në krijimin, bashkimin apo transformimin e njësive institucionale.

9.7 Në rastin e ndryshimeve sipas pikës 9.6 të këtij neni, INSTAT-i kryen klasifikimin përfundimtar të njësive institucionale sipas sektorëve institucionalë në përputhje me metodologjinë ESA 2010, në konsultim me Palët.

9.8 Në rast vështirësie për klasifikimin e një njësie institucionale, ose në rast se Palët nuk bien dakord mbi klasifikimin e saj, Palët mund të kërkojnë opinion metodologjik nga Eurostat-i.

9.9 INSTAT-i është institucioni përgjegjës për mirëmbajtjen, klasifikimin dhe shpërndarjen e listës/regjistrit për korporatat jofinanciare dhe institucionet jofitimprurëse në shërbim të familjeve, në përputhje me metodologjinë ESA 2010 dhe me parimet e legjislacionit shqiptar për statistikën zyrtare dhe Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane.

9.10 INSTAT-i njofton Palët për çdo ndryshim në klasifikimin e njësive institucionale jofinanciare, financiare, familjeve dhe organizatave jofitimprurëse.

9.11 Regjistri i përditësuar i njësive institucionale sipas klasifikimit të sektorëve institucionalë përdoret nga Palët vetëm për prodhimin e statistikave konsistente dhe gjithëpërfshirëse në kuadër të sistemit të llogarive kombëtare, Statistikave të Financave të Qeverisë dhe raportimit në kuadër të Procedurës së Deficitit të Tepërt.

Neni 10 - Shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit

10.1 Për qëllime të këtij Memorandumi, shkëmbimi i të dhënave dhe informacionit ndërmjet Palëve kryhet në përputhje me kuadrin ligjor të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe në përputhje me nenet 31 dhe 33 të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare".

10.2 Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet Palëve realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, kur është e nevojshme, në bazë të urdhrave të përbashkët ndërmjet Palëve. Në përputhje me ligjin "Për statistikën zyrtare", të dhënat statistikore individuale mund të shkëmbehen ndërmjet Palëve vetëm për qëllime statistikore dhe për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare (PSZ).

10.3 Të dhënat e shkëmbyera ndërmjet palëve përdoren vetëm për qëllime statistikore në kuadër të Sistemit Kombëtar Statistikor dhe nuk duhet t'u transmetohen palëve të treta, përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin për statistikën zyrtare.

10.4 Çdo person i punësuar që ka akses në të dhënat e shkëmbyera në kuadër të këtij Memorandumi është i detyruar të respektojë parimet e konfidencialitetit statistikor dhe të nënshkruajë deklaratën përkatëse të konfidencialitetit për përpunimin e këtyre të dhënave.

Neni 11 - Protokollin e Transmetimit të të Dhënave

11.1 Protokollin e transmetimit të të dhënave është një grup i standardizuar rregullash dhe procedurash që rregullojnë mënyrën e formatimit, grupimit, transmetimit dhe marrjes së të dhënave midis Palëve nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe rrjetit të internetit.



11.2 Protokolli siguron integritetin dhe besueshmërinë e të dhënave, duke trajtuar zbulimin e gabimeve, kontrollin e rrjedhës dhe ritransmetimin e grupit të të dhënave ndërmjet Palëve.

Neni 12 – Informimi i Palëve

12.1 Palët bien dakord që:

- a) të informojnë njëra-tjetrën për takimet e planifikuara që lidhen me statistikat e Procedurës së Deficitit të Tepërt dhe Statistikave të Financave të Qeverisë (Komisioni Evropian, Eurostat, FMN, BQE etj.) dhe, kur është e nevojshme, të konsultohen paraprakisht për çështje që lidhen me qëndrimet institucionale;
- b) të informojnë njëra-tjetrën për konferencat, trajnimet dhe seminarat e planifikuara dhe, kur është e përshtatshme, të organizojnë ndarjen e njohurive dhe përvojës së fituar nga pjesëmarrja në këto aktivitete;
- c) të ndajnë konkluzione, raporte dhe materiale të tjera nga mbledhjet, trajnimet, konferencat dhe seminarat, si dhe zhvillimet dhe risitë metodologjike që lidhen me fushat përkatëse statistikore;
- d) të shkëmbejnë informacion mbi metodologjitë dhe praktikën e përpilimit të statistikave, me qëllim rritjen e transparencës dhe sigurimin e konsistencës së treguesve statistikorë;
- e) të ofrojnë, kur është e nevojshme, asistencë reciproke për trajnimin dhe zhvillimin profesional të personelit të përfshirë në prodhimin e statistikave.

12.2 Kur Palët e konsiderojnë të arsyeshme, aktivitetet e pikës 11.1 të këtij neni mund të realizohen edhe nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të përbashkëta, si seminare ose tryeza të rrumbullakëta diskutimi.

Neni 13 - Transmetimi, publikimi dhe shpërndarja e të dhënave

13.1 Palët publikojnë dhe shpërndajnë statistika financiare dhe makroekonomike në përputhje me PSZ, planin vjetor për zbatimin e tij, si dhe me kërkesat e akteve ligjore të Bashkimit Evropian për fushën e PDT/SFQ.

13.2 INSTAT-i informon përdoruesit, në faqen zyrtare elektronike të tij, për burimet institucionale të të dhënave statistikore të publikuara nga BSH dhe MF.

13.3 MF-ja i transmeton FMN-së Pyetësorin e SFQ-ve sipas afatit të përcaktuar nga FMN-ja dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit.

13.4 INSTAT-i është përgjegjës për përpilimin dhe transmetimin në Eurostat të llogarive jofinanciare të SFQ-ve në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive (ESA 2010), Manualin për Deficitin dhe Borxhin e Qeverisë (MGDD eng.) dhe kërkesat e Programit të Transmetimit ESA 2010.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

13.5 BSH-ja është përgjegjëse për përpilimin, publikimin dhe transmetimin e llogarive financiare sektoriale në përputhje me kërkesat e ESA 2010, si për përpilimin e statistikave të borxhit të sektorit të Qeverisë së Përgjithshme sipas përkufizimit të Maastricht-it.

13.6 BSH-ja i transmeton Eurostat-it të dhënat e llogarive financiare sektoriale sipas afateve të përcaktuara nga Programi i Transmetimit ESA 2010 dhe i publikon ato në faqen e saj zyrtare elektronike.

13.7 Palët sigurojnë që statistikave të publikuara të shoqërohen me metadat përkatëse dhe u përgjigjen kërkesave për sqarime mbi të dhënat në përputhje me përgjegjësitë e tyre institucionale.

13.8 Në rast identifikimi të përmirësimeve metodologjike ose rishikimeve të të dhënave, Palët do të koordinojnë ndërmjet tyre për përditësimin e statistikave sipas procedurave të dakordësuara.

Neni 14 - Organizimi dhe bashkëpunimi

14.1 Për zbatimin e këtij Memorandumi, Palët bashkëpunojnë ndërmjet tyre përmes grupit ndër-institucional të punës për Statistikat e Financave të Qeverisë dhe Procedurën e Deficitit të Tepërt.

14.2 Grupi i Punës ngrihet me urdhër të përbashkët ndërmjet palëve. Palët do të caktojnë secili nga dy anëtarë përfaqësues. Nëse është e nevojshme, në takimet e Grupit të Punës mund të marrin pjesë ekspertë të tjerë nga institucionet nënshkruese. Grupi i Punës kryesohet nga INSTAT-i.

14.3 Objektivat, detyrat, përgjegjësitë e anëtarëve dhe mënyra e funksionimit të grupit të punës si dhe të grupeve të tjera të mundshme teknike, përcaktohen nëpërmjet urdhrave të përbashkët ndërmjet Palëve.

14.4 Tabela bashkëngjitur këtij Memorandumi paraqet ndarjen e përgjegjësisë institucionale për përpilimin dhe raportimin e Statistikave Financiare të Qeverisë dhe Tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar.

14.5 Në zbatim të këtij Memorandumi, urdhrat e përbashkët të Palëve mund të përcaktojnë më tej organizimin e punës, përbërjen e grupeve të punës, formatin e raportimit të të dhënave, periodicitetin, si dhe procedurat për gjenerimin, transmetimin dhe publikimin e statistikave makroekonomike dhe financiare.

14.6 Palët bien dakord që anekset dhe dokumentet teknike të lidhura me funksionimin e grupeve të punës mund të përditësohen periodikisht me propozim të grupit përkatës të punës. Përditësimi i tyre hyn në fuqi pas miratimit dhe firmosje nga Palët.

Neni 15. Respektimi i kompetencave institucionale

15.1 Dispozitat e këtij Memorandumi nuk cenojnë kompetencat ligjore dhe përgjegjësitë institucionale të palëve në prodhimin dhe publikimin e statistikave në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë.

Alban



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 16 - Përditësimet

16.1 Palët mund të rishikojnë këtë Memorandum me marrëveshje të ndërsjellë në rast të ndryshimeve në kuadrin ligjor ose metodologjik.

16.2 Çdo ndryshim në këtë memorandum do të bëhet me shkrim dhe me pëlqimin e të tre palëve.

16.3 Në rastet kur përmbushja e parashikimeve të këtij memorandum shoqërohet me kosto financiare, Palët do të angazhohen për marrjen përsipër të tyre respektivisht, në përputhje me rregullat e tyre institucionale.

Neni 17 - Hyrja në fuqi dhe Shfuqizime

17.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga Palët për një afat të pacaktuar. Secila nga Palët mund ta zgjidhë këtë Memorandum Mirëkuptimi nga efektet në çdo kohë, duke njoftuar palët e tjera jo më vonë se 60 ditë përpara.

Neni 18 - Të tjera

18.1 Memorandumi i Mirëkuptimit nr. 1146 prot., datë 3 tetor 2016 i nënshkruar ndërmjet INSTAT, BSH dhe MFE, shfuqizohet.

PËR:

MINISTRINË E
FINANCËVE

PETRIT MACAJ
MINISTËR

PËR:

BANKËN E SHQIPËRISË

Geni Lejha
GUVERNATOR

PËR:

INSTITUTIN E
STATISTIKAVE

Lantona Sado
DREJTORI
PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ANEKSI 1:

Tabelë: Institucionet përgjegjëse për përgatitjen e Statistikave Financiare të Qeverisë dhe Tabelave të Procedurës së Deficitit të Tejkualuar

Institucionet përgjegjëse		INSTAT	MF	BSH
Përpilimi i Llogarive Kombëtare për Sektorin e Qeverisë Përgjithshme				
Llogaritë Jofinanciare	Vjetore (ESA2010, Tabela 2)	X		
	Tremujore (ESA2010, Tabela 25)	X		
Taksat dhe kontributet shoqërore	Vjetore (ESA2010, Tabela 9)	X		
Shpenzimet qeveritare sipas funksionit	Vjetore (ESA2010, Tabela 11)	X		
Llogaritë Financiare	Vjetore (ESA2010, Tabela 6 dhe 7)			X
	Tremujore (ESA2010, Tabela 27)			X
Borxhi i Maastricht-it	Tremujore (ESA2010, Tabela 28)			X
Përpilimi i raportit të EDP:				
EDP tabela 1	Të dhëna aktuale	Deficiti/Suficiti	X	
		Borxhi		X
		Variabla të tjerë	X	
	Të dhëna të planifikuara	Deficiti/Suficiti		X
		Borxhi		X
		Variabla të tjerë		X
EDP tabela 2	Të dhëna aktuale	2A Qeveria Qendrore	X	
		2C Qeveria Lokale	X	
		2D Fondet e Sigurimeve	X	
EDP tabela 3		3A Qeverisja e Përgjithshme	X	X
		3B Qeveria Qendrore	X	X
		3D Qeveria Lokale	X	X
		3E Fondet e Sigurimeve	X	X
EDP tabela 4			X	X